



**AKTI I THEMELIMIT  
TË  
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
"UNIVERSITETI AMERIKAN I TIRANES" (U.A.T) Sh.p.k**

Në Tiranë, më date 30.05.2008:

Shoqëria "MEDICOM APTC" sh.p.k e themeluar si e tille me Vendim te Gjykates se Rrethit Tirane nr. 27716, date 10.05.2002, perfaqesuar nga Plarend Ndreu, i biri i Et'hemit, datlindja 26.07.1981, lindur ne Vlore, banues ne Tirane, rruga "M. Keta" ish 3700 Kinostudio.

Lulëzim Ndreu, i biri i Et'hemit, datelindja 16.05.1972, lindur ne Vlore dhe banues ne Tirane, rruga "Grigor Heba", pall 40, shk 2, ap 2/1.

Themelojnë shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar "UNIVERSITETI AMERIKAN I TIRANES"(U.A.T)sh.p.k dhe hartojnë për këtë qëllim Aktin e Themelimit të shoqërisë me përmbajtje si vijon:

**NENI 1**

**EMËRTIMI I SHOQËRISË**

Emërtimi i shoqërisë është "UNIVERSITETI AMERIKAN I TIRANES"(U.A.T) sh.p.k.

**NENI 2**

Shoqëria krijohet dhe ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe veçanërisht mbështetur në nenin 2 paragrafi „B“ i Ligjit „Për sanksionet dhe mbrojtjen e pronës private dhe nisjes së lirë të veprimtarisë private, të pavarur dhe të privatizimit“, në legjislacionin në fuqi, "Për Shoqëritë Tregtare", në të cilën ata janë ortakë dhe për këtë qëllim hartojnë Aktin e Themelimit të tij, me përmbajtjen si vijon:

**NENI 3**

**FORMA**

Shoqëria "UNIVERSITETI AMERIKAN I TIRANES"(U.A.T) sh.p.k është Shoqëri me Përgjegjësi të kufizuar sh.p.k.

**NENI 4**

4.1 Selia e shoqërisë do të jete ne: Autostrada Tirane-Durres, km 1, godina U.A.T



**NENI 5**

**OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË**

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë :

Aktivitetet në fushen e arsimit privat, te larte universitar dhe pasuniversitar, kolegeje e dhe kurse afatshkurter, afatmesem e afatgjate para dhe pasuniversitar.

Import-eksport dhe tregtim me shumice e pakice cdo artikulli dhe mall, pa kufizim, qe lejohet nga legjislacioni shqiptari ne fuqi dhe qe ka lidhje me aktivitetin privat te shoqerise etj.

**NENI 6**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë mbi 20 vjet dhe do të fillojë nga momenti i regjistrimit të saj në Qendren Kombetare te Regjistrimit me përjashtim të rasteve kur mbaron sipas parashikimeve në ligj ose kur vendos asambleja e ortakëve

**NENI 7**

**TERRITORI**

Shoqëria e zhvillon aktivitetin e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj, gjithashtu ajo mund të hapë, filiale, degje, ose përfaqësi në rrethe të ndryshme të Republikës së Shqipërisë, apo në shtete të tjera, në përputhje me legjislacionin e vendeve përkatëse.

**NENI 8**

**KAPITALI DHE PJESËT**

Kapitali themeltar i shoqërisë ka vlerën 1 000 000 lekë (një milion) i cili ndahet në 100 pjesë secila me vlerë prej 10 000 lekë.

Kapitali themeltar i shoqërisë mund të zmadhohet, me vendim të marë prej ortakëve. Në rast zmadhimi të kapitalit themeltar nëpërmjet shtimit të pjesëve të reja, ortakët kanë të drejtën e përparësisë në nënshkrim, proporcionalisht me shumën e pjesëve të tyre, e drejtë nga e cila ata mund të heqin dorë.

Kapitali themeltar i shoqërisë, mund të zvogëlohet me vendim të marrë nga e Asamblesë së Ortakëve. Zvogëlimi i kapitalit i prek të gjithë ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që ata përfaqësojnë.

**NENI 9**

**KONTRIBUTET**

Kapitali themeltar i shoqërisë, zotërohet nga ortakët e shoqërisë, Shoqëria "MEDICOM APTC" sh.p.k dhe Lulëzim Ndreu si vijon:

Ortaku Shoqëria "MEDICOM APTC" sh.p.k zotëron 50 % të të gjithë vlerës së kapitalit, të përbërë nga 50 pjesë, me vlerë totale prej 500 000 lekë (peseqind).



**NENI 10**

**ADMINISTRIMI**

Shoqëria administrohet nga një ose me shume administratorë të cilët janë persona fizike të zgjedhur brenda bashkësisë së ortakëve apo dhe jashtë saj, një i emruar me perfaqesine e ortakëve me shumice dhe tjetri ne perfaqesine e ortakëve ne pakice.

Ne vazhdim administratorët emërohen dhe shkarkohen me vendim të ortakëve që përfaqësojnë mbi 70 % te kuotave.

Emërimi i administratorit ose administratorëve bëhet për një afat 3(tre) vjecar, me përjashtim të rastit të dorëheqjes ose të shkarkimit të parakohshëm para mbarimit të afatit. Shkarkimi i administratorëve nga organi kompetent mund të bëhet në cdo kohë.

**NENI 11**

**KOMPETENCAT E ADMINISTRATORËVE**

Administratorëve iu njihet e drejta për të ushtruar të gjitha kompetencat për kryerjen e veprimeve të administrimit dhe të përfaqësimit në emër të shoqërisë, në interes të saj dhe nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e Shoqërisë, Principet e Biznesit dhe vendimet e Asamblesë së ortakëve të shoqërisë, me përjashtim të atyre kompetencave që ligji dhe statuti ia japin shprehimisht ortakëve.

**NENI 12**

**EMËRIMI I PARË I ADMINISTRATORËVE**

Administrator i shoqërisë për periudhën 3-vjecare emërohet ortakë i shoqërisë Lulëzim Ndreu.

Akti i Themelimit u përplua në gjuhën shqipe, në katër kopje origjinale, duke pasur të gjitha fuqitë ligjore të barabarta për t'u administruar sipas ligjit.

**ASAMBLEJA E ORTAKEVE**

Shoqëria "MEDICOM APTC" sh.p.k

Adm Plarend Ndreu



Lulëzim Ndreu

*Lulëzim Ndreu*



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA E NOTERISË TIRANË  
NR 5122 REP NR 1027 KOL  
Notere Dhimitra QARRI**

**Adresa : Blv „ B Curri“ pranë Gjykatës së  
Rrethit Gjyqesor Tiranë Tel 251 200/0692095571**

**VERTETIM NENSHKRIMI**

Ne Tirane, sot me daten 30.05.2008 para meje noteres publike Dhimitra Qarri, u paraqiten:

Shoqëria "MEDICOM APTC" sh.p.k e themeluar si e tille me Vendim te Gjykates se Rrethit Tirane nr. 27716, date 10.05.2002, perfaqesuar nga Plarend Ndreu, i biri i Et'hemit, datlindja 26.07.1981, lindur ne Vlore, banues ne Tirane, rruga "M. Keta" ish 3700 Kinostudio, i njohur personalisht prej meje.

Lulëzim Ndreu, i biri i Et'hemit, datelindja 16.05.1972, lindur ne Vlore dhe banues ne Tirane, rruga "Grigor Heba", pall 40, shk 2, ap 2/1, i njohur personalisht prej meje, me cilesine e ortakëve te shoqerise "UNIVERSITETI AMERIKAN I TIRANES"(U.A.T)sh.p.k, madhore, me zotesi te plote juridike per te vepruar, te cilet me vullnet te lire e te plote deklaruan se sa me siper eshte akti i themelimit, perpiluar prej tyre jashte kesaj zyre noteriale, nenshkruajne ne pranime time dhe une e vertetoj ate sipas ligjit.

**NOTERE**

**Dhimitra Qarri**



*Dhimitra Qarri*